

1 E hënë, 21 qershor 2021

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve në
7 sallë dhe jashtë saj.

8 Zonja sekretare, mund të thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
10 Gjykatës, është çështja BSC-KS-2020-04 (sipas përkthimit)
11 Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Dhe tani i
13 lutem palëve të prezantohen, duke e filluar nga Zyra e
14 Prokurorit të Specializuar.

15 Po, zonja prokurore, nuk e di se cili nga ju do të flasë.

16 Z. O'DOWN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar dhe
17 mirëmëngjes. Mirëmëngjes të gjithëve. Në emër të Zyrës së
18 Prokurorisë së Specializuar është Vega Iodice, bashkëprokurore
19 Angel Langenbergdhe unë jam prokurori.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani Mbrojtja, ju lutem.
21 Mos harroni mikrofonin.

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] Duke mbajtur maskën harrova
23 mikrofonin.

24 Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Zoti kryetar do t'ju
25 prezantoj anëtarët e ekipit. Znj. Leta Cariolou, avokate nga

1 Qiproja dhe nga Anglia dhe Uells; znj. Tina Korosec, që vjen
2 nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të njeriut; e treta,
3 Dzeneta Petravica, që ju është bashkangjitur ekipit si
4 stazhiere. Ju e njihni ndërkohë kolegun tim Hedi Aouini, që
5 është nga Tunizia dhe vetë unë, që jam z. Jean-Louis Gilissen.

6 Ne kemi kënaqësinë t'ju raportojmë se ekuilibri gjinor
7 është vendosur; në fakt, ne si burra kemi humbur.

8 Znj. Felaj (sipas përkthimit) është këtu me ne.

9 Z. Shala është këtu me ne me videolink nga qendra e
10 paraburgimit në Sheveningen. Faleminderit shumë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z.
12 Gilissen dhe ju urojmë përgëzime për ekuilibrin gjinor që keni
13 vendosur. Por, e di që edhe nga ana tjetër, po ashtu kanë
14 vendosur një ekuilibër të mirë gjinor. Por është edhe këtu në
15 rreshtin e parë. I vetmi që jam i vetëm pa barazi gjinore, jam
16 unë.

17 Tani t'i kthehem sekretares.

18 Zonja sekretare. Më falni, administratores.

19 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Unë jam Fidelma Donlon dhe
20 bashkë me mua është dhe zëvendësadministratori z. Stefan
21 Wohlfahrt.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Si gjithmonë, ju kujtoj të gjithëve, të flisni me ngadalë
24 përpara sesa të përgjigjeni me qëllim që përkthyesit të kenë
25 mundësi t'i përkthejnë të gjitha që do të thoni ju në shqip

1 dhe në serbisht.

2 Në 7 qershor caktova konferencën e dytë për ecurinë e
3 çështjes.

4 Në këtë çështje sot, kam për qëllim të shohim se ku jemi
5 me ecurinë e çështjes për të siguruar një ecuri të mirë të
6 procedurave për gjyq. Dua të diskutoj në veçanti nxjerrjen e
7 materialeve provuese, ecurinë e hetimeve të Prokurorit të
8 Specializuar, datën kur ZPS-ja mendon të dorëzojë dosjen
9 paragjyqësor dhe materiale të lidhura me të, qëndrimin e
10 Mbrojtjes në lidhje me ecurinë e hetimeve, qëllimin për të
11 dhënë alibi apo arsye për përjashtimin e përgjegjësisë dhe
12 qëllimin e saj për të bërë kërkesa lidhur me mundësi unike
13 hetimore.

14 Gjithashtu, dua të diskutoj dhe afatet kohore për çdo
15 mocion paraparak në fund të kësaj konference, gjithashtu, do të
16 nxjerr një urdhër me gojë për këtë çështje.

17 Dhe, së fundi, çdo çështje tjetër që palët kanë dëshirë
18 të ngrenë.

19 E falënderoj ZPS-në dhe Mbrojtjen për parashtrimet e tyre
20 me shkrim përpara kësaj konference dhe si zakonisht, ftoj
21 palët të paraqesin mendimet e tyre shkurtimisht për çdo pikë
22 të agjendës të cilat unë do t'i trajtoj veç e veç. Gjithashtu,
23 u kujtoj të gjithëve të pranishëm në këtë sallë gjyqi të japin
24 njoftim paraparak nëse duhet të futemi në seancë të mbyllur apo
25 private, në raste se kanë informacione konfidenciale.

1 Po fillojmë me procesin e nxjerrjes së materialeve. ZPS-
2 ja në parashtrimet e saj me shkrim vuri në dukje se ka
3 përfunduar nxjerrjen e materialeve në bazë të rregullit 102
4 (1)(a) në 19 maj 2021. Por, unë konstatoj se ZPS-ja tregon se
5 më pas nxori një version të paredaktuar të një dokumenti. E
6 falënderoj ZPS-në [dhe] të na vërë në dukje se kur ka ndodhur
7 kjo gjë.

8 Gjithashtu, konstatoj se dy paketat me materiale të
9 nxjerra, numri 8 dhe 9, janë nxjerrë në 11 qershor 2021.
10 Dëshiroj që ZPS-ja të na tregojë nëse këto paketa përmbajnë
11 materiale të rregullit 102(1)(a) gjithashtu, sikurse thotë
12 Mbrojtja në parashtrimet e saj me shkrim, rast në të cilin do
13 të themi që ZPS-ja ka përfunduar vetëm nxjerrjen e materialeve
14 në bazë të rregullës 102(1)(a) në 11 qershor. Sigurisht, kjo
15 ka një ndikim për afatin e Mbrojtjes për të parashtruar
16 mocionet paraprake të saj.

17 ZPS-ja gjithashtu vuri në dukje se është në proces të
18 rishikimit të materialeve në bazë të rregullit 102(1)(b) për
19 nxjerrje dhe redaktime. Si rezultat i këtij shqyrtimi, në
20 vazhdim ZPS-ja parashtroi kërkesën e dytë për masa mbrojtëse
21 në 11 qershor, që është në pritje të vendoset.

22 ZPS-ja vuri në dukje se grupi i parë i dokumenteve në
23 bazë të rregullave 102(1)(b) që nuk kërkon masa mbrojtëse do
24 t'i bëhet i njohur Mbrojtjes menjëherë. E ftoj ZPS-në të na
25 tregojë nëse kjo është bërë, pjesërisht apo plotësisht, me

1 grupin 10, të nxjerrë të premtën; dhe, nëse jo, kur ajo synon
2 ta nxjerrë këtë material.

3 Gjithashtu, ZPS-ja vuri në dukje se po vazhdon shqyrtimin
4 e materialeve të rregullit 103 që e ka në zotërimin e saj,
5 kontroll apo në dijeninë e saj dhe pas kërkesës së redaktimeve
6 të kërkuara, ajo do të nxjerrë menjëherë çdo material të tillë
7 pak nga pak. Nëse ZPS-ja na tregon nëse janë identifikuar
8 materiale të tilla dhe kur, nëse ajo mendon se ka një afat të
9 përafërt të përfundimit të nxjerrjes.

10 Dhe, së fundi, ZPS-ja vuri në dukje se vazhdon të
11 angazhohet me ofruesit për të kërkuar miratime në bazë të
12 rregullit 107 në lidhje me një sasi të caktuar materialesh të
13 mbrojtura që lidhen me këtë çështje. E ftoj ZPS-në të na japë
14 informata për numrin e dokumenteve provë që, për të cilat
15 bëhet fjalë, numrin e ofruesve me të cilët është konsultuar
16 dhe, çdo tregues për afatet kohore të miratimit të tyre. Dhe,
17 më në përgjithësi, dua të dëgjoj nga Prokuroria nëse ka pasur
18 vështirësi në procesin e vazhdueshëm të nxjerrjes së
19 dokumenteve apo nëse kanë ndonjë problem, ndonjë vështirësi
20 lidhur me kalendarin e nxjerrjes.

21 Shumë pyetje ju bëra. Shpresoj t'i mbani mend. Prokurorë,
22 tani keni fjalën. Nëse s'ju kujtohet, do t'jua kujtoj unë.

23 Z. O'DOWN: [Përkthim] Faleminderit. Jemi mirënjohës për
24 ato që thatë.

25 Nxjerrja e materialeve vazhdon ashtu siç është

1 parashikuar. Neve i kemi respektuar të gjitha afatet dhe nuk
2 kemi pasur ndonjë vështirësi lidhur me nxjerrjen e materialeve
3 provuese.

4 ZPS-ja besoj se do të respektojë afatet e përcaktuara në
5 Vendimin Kuadër. Ne e kemi nxjerrë në kohë Aktakuzën,
6 përshkrimin e hollësishëm, materialet në bazë të rregullit
7 102(1)(a) dhe 102(1)(b), me redaktime standarde.

8 Në rastin e dokumenteve që ju përmendët, janë paraqitur
9 pa redaktime në 11 qershor dhe shumë pak redaktime janë hequr.

10 Ne jemi takuar disa herë me kolegët e Mbrojtjes në kuadër
11 të përpjekjeve për t'u dhënë atyre materiale që ju duhen dhe
12 që kanë të drejtë t'i marrin. Këto takime kanë qenë shumë
13 produktive. Na kanë ndihmuar që ata të kuptojnë se cilat
14 materiale kanë rëndësi të veçantë për ta, janë më me përparësi
15 dhe ne po vazhdojmë të punojmë në mënyrë sistematike dhe të
16 organizuar.

17 Në lidhje me materialet në 11 qershor 2021, në fakt ato
18 përmbanin materiale të rregullit 102(1)(a) po ishin vetëm
19 materiale të cilat ishin nxjerrë në 19 maj dhe shumë pak
20 redaktime u bënë në grupin e dytë. Pra, në 19 qershor ka
21 përfunduar nxjerrja e këtyre, -- më falni, 19 maj, ka
22 përfunduar nxjerrja e këtyre materialeve.

23 Në fakt, përfunduar të premtën nxjerrjen e materialeve
24 102(1)(b) siç pritej.

25 Në lidhje me materialet e rregullit 102(3), kemi filluar

1 procesin. Procesi do të përfundojë në 30 korrik.

2 Për sa i takon materialeve të rregullit 107, ne
3 aktualisht po merremi me ofruesit e tyre për disa dokumente.
4 Në fakt, numri i tyre është më pak se 20 dokumente. Nuk kemi
5 hasur ndonjë vështirësi për ta ngritur në Gjykatë. Kemi vetëm
6 një ofrues që është përfshirë në këtë, por do ta përditësojmë
7 Gjykatën në rast se do të kemi ndonjë zhvillim për këtë
8 çështje.

9 Kolegia më sqaroi se nxjerrja që përfundoi të premtën
10 ishte e dyta e pjeshme e dokumenteve 102(1)(b). Do të
11 vazhdojmë me punën tonë për nxjerrjen e të gjithë materialeve
12 102(1)(b) deri në fund të korrikut.

13 Shpresoj që t'i jem përgjigjur të gjithave pyetjeve.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po.

15 Për dokumentet 102(1)(a), ju thatë "nuk janë materiale të
16 reja por janë materiale ku janë hequr disa redaktime"?

17 Z. O'DOWN: [Përkthim] Po. Vetëm një numër shumë i vogël
18 redaktimesh.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Tani po i kthehem Mbrojtjes. Mbrojtja në parashtrimet e
21 saj me shkrim vuri në dukje se masat mbrojtëse të kërkuara nga
22 ZPS-ja kanë ndikim në drejtësinë e procedurave dhe mundësinë e
23 saj për t'u përgatitur për gjyq. Por, kjo nuk është një
24 çështje që duhet diskutuar me hollësi në këtë konferencë sot,
25 por ju ftoj që në përgjigjen tuaj ndaj kërkesës së dytë të

1 ZPS-së për masa mbrojtëse, ju t'i parashtroni këto çështje.

2 Mbrojtja gjithashtu vuri në dukje se redaktimet e mëdha
3 të materialeve që janë bërë të njohura deri tani dhe fakti që
4 identiteti i shumë dëshmitarëve që do të thirren të dëshmojnë
5 nuk ju është bërë i njohur Mbrojtjes, kjo e ka penguar atë që
6 të njoftohet si duhet lidhur me çështjen e Prokurorisë.

7 Prandaj, ju jap fjalën të diskutoni ndonjë vështirësi
8 lidhur me pikat, me materialet e nxjerra dhe këto që sapo ju
9 thashë.

10 Keni fjalën.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
12 Gjykatës.

13 Po filloj me marrëdhënien që kemi me ZPS-në, me ekipin e
14 ZPS-së të znj. Iodice dhe O'Dowd. Dua të theksoj nivelin e
15 lartë të marrëdhënies profesionale midis ekipit tonë dhe
16 ekipit të Prokurorisë. Deri tani mund të them se është një
17 marrëdhënie e cilësisë më të lartë.

18 Procesi i nxjerrjes së materialeve si mbas rregullit
19 102(1)(a) është zhvilluar dhe ka ecur pa probleme fare. Dhe me
20 dashamirësinë më të madhe doja ta theksoja këtë aspekt.

21 Kolegu na ka konfirmuar se nxjerrjet e materialeve sipas
22 këtij rregulli janë plotësuar. Por, kolegu ra dakord që të na
23 japë disa incizime në video që lidhen me vetë të akuzuarin.
24 Pra, kjo lloj marrëveshje duhet lavdëruar për mendimin tim,
25 sepse na e jep mundësinë të gjithëve të punojmë si duhet dhe

1 të shmangen keqkuptimet apo diskutime të panevojshme.

2 Ne i kemi bërë disa ngarkesa tona ZPS-së dhe jemi duke
3 diskutuar me ta rregullisht me qëllim për të përcaktuar
4 përparësitë e dokumenteve, dëshmime të caktuara që ne i
5 konsiderojmë të nevojshme lidhur me materialet, për t'i
6 kuptuar më mirë materialet e nxjerra përpara. Pra, presim të
7 vazhdojmë këtë bashkëpunim konstruktiv me ZPS-në.

8 Unë në këtë moment, i nderuar Gjykatës nuk kam tjetër për
9 të shtuar lidhur me çështjen e parë që ju vutë në dukje. Pra,
10 mendoj që është një shenjë e mirë. Faleminderit që më dëgjuat.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë, z.
12 Gilissen.

13 Zoti prokuror, dëshironi të shtoni diçka lidhur me
14 komplimentet që ju bëri Mbrojtja, që nuk ndodh shumë shpesh në
15 këtë sallë gjyqi.

16 Z. O'DOWN: [Përkthim] Faleminderit. Jo, jemi mirënjohës
17 edhe ne për bashkëpunimin e mirë me kolegët e Mbrojtjes.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

19 Kam një pyetje, z. Gilissen. Për atë që thashë lidhur me
20 nxjerrjen e materialeve në bazë të rregullit 102(1)(a) mendoni
21 se i keni marrë të gjitha materialet në 19 maj, siç tha
22 Prokuroria, apo në 11 qershor? Sepse kjo është data kur janë
23 bërë të njohura dokumentet me më pak redaktime.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ne i kemi marrë dokumentet e
25 fundit më 11 qershor.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. E mbajta
2 shënim.

3 Zoti prokuror, dëshironi të shtoni gjë?

4 Z. O'DOWN: [Përkthim] Redaktimet që ne hoqëm ishin
5 standarde nuk prekin, -- nuk kanë të bëjnë me afatet e
6 zbatueshme.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
8 prokuror.

9 Nëse Mbrojtja nuk ka gjë tjetër për të shtuar po kalojmë
10 tek pika e dytë në agjendën tonë, që është ecuria e hetimeve
11 të ZPS-së.

12 Në parashtrimet e saj, ZPS-ja vuri në dukje se kanë
13 mbetur ende disa hapa hetimore për t'u ndërmarr. Por, duke pas
14 parasysh natyrën e kufizuar të këtyre hapave, ato mendojnë se
15 kjo nuk do të ndikojë në afatet e nxjerrjes së materialeve.

16 Zoti prokuror, kur mendoni t'i përfundoni këto hapat
17 hetimore që përmenden në parashtrimet me shkrim?

18 Z. O'DOWN: [Përkthim] Mendojmë përpara fundit të
19 nxjerrjes -- afatit të nxjerrjes së materialeve që është 30
20 korriku. Nëse nuk do të mundemi, do t'ju njoftojmë
21 përkatësisht.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E mbajta shënim.
23 Faleminderit.

24 Tani i kthehem Mbrojtjes. Z. Gilissen, dëshironi të
25 shtoni diçka për këtë pikë?

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, faleminderit shumë, i
2 nderuar Gjykatës. Edhe ne i mbajtëm shënim këto.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

4 Kalojmë tek dosja paragjyqësore e Prokurorisë dhe
5 materialet e lidhura me të.

6 Në parashtrimet e saj, ZPS-ja vë në dukje se duke pasur
7 parasysh kalendarin e përcaktuar me Vendimin Kuadër, që
8 mendohet se do të vazhdojë deri në tetor 2021, ZPS-ja
9 parashikon se do të mund të dorëzojë dosjen paraprake dhe
10 materialet e lidhura me të deri të premtën, 19 nëntor 2021.

11 Zoti prokuror, dëshironi t'i shtoni gjë parashtrimeve
12 tuaja me shkrim apo nëse mund të konfirmoni që kjo është data
13 kur duhet të japim urdhër që ju të dorëzoni dosjen tuaj
14 paraprake?

15 Z. O'DOWN: [Përkthim] Nëse është e pranueshme për ju, ne
16 u përmbahemi parashtrimeve.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Gilissen, lidhur me datën kur ZPS-ja do të dorëzojë
19 dosjen e saj paragjyqësore.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. As ne nuk kemi gjë
21 për të shtuar apo për të thënë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, mbrojtës.

23 Tani që dëgjova palët, do të jap urdhrin e parë me gojë,
24 lidhur me parashtrimet e dosjes paragjyqësore.

25 Urdhëroj tani Prokurorinë që të dorëzojë dosjen e saj, si

1 mbas rregullit 95(4)(a) të Rregullores deri në 19 nëntor 2021,
2 më e fundit.

3 Këtu përfundon urdhri im me gojë.

4 Sa i takon pikës tjetër të rendit të ditës, do t'i
5 kthehem në fillim Mbrojtjes.

6 Vë re këtu parashtrimet me shkrim të Mbrojtjes se
7 konfirmon synimin për të kryer hetime me qëllim paraqitjen e
8 çështjes së saj.

9 Z. Gilissen, në bazë të informacioneve që ka dhënë
10 prokurori gjatë konferencës për ecurinë e çështjes, a jeni në
11 gjendje që të shtjelloni më tej informacionet e dhëna në
12 parashtrimet tuaja me shkrim, së pari, lidhur me ecurinë e
13 hetimeve tuaja; së dyti, lidhur me synimin tuaj për të dhënë
14 njoftim për alibinë apo arsyen për të përjashtuar
15 përgjegjësinë penale dhe nxjerrjet e lidhura me këtë; dhe së
16 treti, lidhur me synimin tuaj për të bërë kërkesa sa u takon
17 mundësive hetimore unike?

18 Z. Gilissen, fjala është për ju.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
20 Gjykatës. Unë do të përpiqem që të shpjegoj sa i takon asaj që
21 u tha.

22 Për afatin e ardhshëm për nxjerrjen e materialeve nga
23 ZPS-ja në bazë të rregullit 102(1)(b) është data 30 korrik
24 2021. Ne mendojmë se do të marrim materiale të rëndësishme të
25 cilat do të na jepnin neve mundësi të kuptonim më mirë provat

1 dhe materialet që do të përdoren në gjykim. Kështu që ne
2 mendojmë se -- jam i sigurt që gjërat do të shkojnë, do të
3 ecin pa asnjë problem. Mendojmë se do të jemi në një gjendje
4 më të mirë t'ju informojmë ju, zoti Gjykatës, me informacion
5 lidhur me ecurinë dhe synimet tona në konferencat e ardhshme
6 për ecurinë e çështjes.

7 I nderuar Gjykatës, organizimi i hetimeve në terren është
8 shumë i vështirë dhe shumë delikat. Duhet të më besoni për
9 këtë. Unë mund të them që tani se kemi identifikuar një sërë
10 individësh të aftë për të na mbështetur dhe asistuar në terren
11 me hetimet tona. Do të tregojmë kujdesin maksimal - e
12 nënvijëzojmë këtë "kujdesin maksimal" - në përzgjedhjen e
13 personave me të cilët ne bashkëpunojmë dhe veprimet që do të
14 bëjmë.

15 Jam i sigurt, i nderuar Gjykatës, se ju e kuptoni se
16 është e vështirë që të shtoj diçka tjetër në këtë fazë.

17 Sa i takon alibisë apo arsyeve për përjashtim të
18 përgjegjësisë, hë për hë, si Mbrojtje nuk jemi në gjendje që
19 të themi diçka për këtë, e njëjta vlen edhe sa i takon
20 mundësisë hetimore unike. Mund të flas vetëm për akuzën e
21 ngritur në bazë -- apo të tabelës të listës -- në bazë të
22 rregullit 109, ne kemi marrë vetëm një, nga kolegët tanë nga
23 Prokuroria, kemi marrë vetëm një tabelë modulare lidhur me
24 këtë, por do t'ju informojmë më shumë lidhur me këtë në
25 konferencat e ardhshme për ecurinë e çështjes.

1 Do doja që të flisja dhe për kërkesën tonë, por mbase më
2 mbrapa, ma merr mendja. Faleminderit shumë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.

4 Diçka sa i takon çështjeve që ju sapo ngritët. Nëse
5 dëshironi që të ngrini ndonjë prej këtyre pistave mbrojtëse,
6 qoftë arsyes për përjashtim të përgjegjësisë penale, apo edhe
7 mundësi për të -- për edhe mundësi -- kërkesë për mundësi
8 hetimore unike, ju lutem ta bëni këtë në kohën e duhur brenda
9 një -- për të dhënë mundësi që të mos ketë vonesa sepse janë
10 çështje që kërkojnë kohë.

11 Zoti prokuror, dëshironi që të shtoni diçka lidhur me
12 këtë temë?

13 Z. O'DOWN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk kemi
14 asgjë për të shtuar tani.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
16 prokuror.

17 Tani, dëshiroj që t'i lutem Mbrojtjes dhe ZPS-së që të
18 japin mendimet e tyre sa i takon kalendarit procedural për
19 mocionet paraprake. Që në fillim, përfitoj nga rasti që t'i
20 kujtoj Mbrojtjes se kërkesat për zgjatje të afateve, qoftë kjo
21 për mocion paraprake apo edhe për parashtrime të tjera të
22 protokolluara duhet që të bëhen me shkrim, jo me postë
23 elektronike.

24 Vëre këtu kërkesat e Mbrojtjes për zgjatje të afatit në
25 mënyrë që afati për dorëzimin dhe parashtrimet e protokolluara

1 sa i takon mocioneve të lartpërmendura paraprahe, të shtyhet
2 deri më datën 11 korrik 2021. Kjo do t'i jepte mundësi
3 Mbrojtjes që të kryente funksionet e veta siç duhet.

4 Do t'i lutesha Mbrojtjes nëse kërkesa e vet, -- nëse
5 kërkesat -- nëse kërkon, - më falni -, që të lejohet që të
6 dorëzojë mocione paraprahe në këtë datë apo qoftë edhe më
7 herët dua t'i kujtoj secilës palë që, nëse kanë nevojë që të
8 përgatiten, të përgjigjen apo të kundërpërgjigjen për mocionet
9 paraprahe për sa kohë që kalendari është i arsyeshëm dhe, nëse
10 nuk shkakton vonesa për procedurën në përgjithësi, këto gjëra
11 mund të bëhen.

12 I lutem Mbrojtjes që të paraqesë pikëpamjet e veta lidhur
13 me këtë.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës.

15 Ne vendosëm që të dorëzojmë këtë kërkesë sepse jemi duke
16 punuar në mënyrë paralele për mocionet paraprahe. Synojmë që
17 të dorëzojmë mocionin e parë paraprahe për të kundërshtuar
18 juridiksionin e DHSK-së në bazë të rregullit 19(7)(1) (sipas
19 përkthimit) dhe, një mocion tjetër paraprahe që kundërshton
20 formën e Aktakuzës në bazë të rregullës 97(2).

21 Prandaj jua kemi dërguar këtë kërkesë, i nderuar
22 Gjykatës, me postë elektronike, kërkoj ndjesë për këtë, më
23 datë 15 qershor dhe i kemi duplikuar këto parashtime në
24 parashtimin e protokolluar të datës 17 qershor që kemi bërë
25 për konferencën dhe ecurinë e çështjes.

1 Për të bërë një përmbledhje të qëndrimit tonë, ne
2 kërkojmë shtyrje të afatit për të dorëzuar mocionet paraprake
3 deri më 11 qershor 2021.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen, besoj e keni
5 fjalën për 11 korrikun?

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] Thashë qershor?

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po. Madje thatë 2001.
8 Besoj e keni fjalën për 2021.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, po është më se gabim.

10 Pra, më datë 25 maj 2021, kemi marrë Aktakuzën e
11 redaktuar që na jep neve dhe z. Shala dhe mund të them që, z.
12 Shala ka një opinion të fortë lidhur me këtë, për të kuptuar
13 më mirë akuzat.

14 Së dyti, më 11 qershor, me kërkesën tonë, kemi marrë një
15 material të ri në bazë të rregullit 102(1)(a) të ZPS-së, 112
16 (1)(a) të ZPS-së. Ne parashtrojmë se ky është material i një
17 versioni në video të transkriptit që na ishte nxjerrë më
18 përpara të një interviste të të akuzuarit por, që është e
19 nevojshme për të punuar siç duhet me z. Shala.

20 Këto -- ky element është shumë i nevojshëm për të
21 ndihmuar mbrojtësen, Mbrojtjen, - më falni -, dhe z. Shalaj,
22 dhe nënvizoj z. Shala, për të verifikuar dhe saktësuar disa
23 informacione.

24 Së treti, siç është në dijeni dhe i nderuari Gjykatës, ne
25 punojmë me një nivel bazë buxheti dhe financimi të ekipeve të

1 mbrojtjes në bazë të regjimit të DHSK-së. Fatkeqësisht për ne,
2 ky nivel buxhet është konfirmuar së fundmi nga Zyra
3 Administrative për fazën paraprake, kështu që do të vijojmë që
4 të bëjmë çmos që të kryejmë detyrën tonë për ta mbrojtur z.
5 Shala në këtë proces me korrektesë dhe me efikasitet.

6 Po punojmë aktualisht në disa fronte. Si sa i takon
7 provave, po ashtu edhe sa i takon bazës juridike, por edhe në
8 kuadër -- po punojmë edhe për të ngritur ekipin tonë në Hagë
9 dhe, sigurisht, edhe për të bërë hetimet në terren. E gjitha
10 kjo kërkon shumë kohë edhe energji dhe janë çështje shumë
11 delikate me të cilat përballemi ndonjëherë.

12 Mbrojtja e z. Shala parashtron se mocionet paraprake janë
13 elemente thelbësore të mbrojtjes për z. Shala por gjithashtu
14 janë dhe një komponent i rëndësishëm i kësaj çështjeje
15 gjyqësore.

16 Z. Gjykatës, kemi nevojë deri më datë 11 korrik të vitit
17 2021 që ta bëjmë siç duhet këtë mocion paraprak. Nuk po
18 kërkojmë ndonjë luks, i nderuar Gjykatës. Javën e ardhshme të
19 gjithë kanë një pushim më se të merituar në mënyrë që të
20 rimarrim dhe të rigrupojmë veten. Shpresojmë që të përfitojmë
21 nga kjo periudhë pushimi sepse jemi të gjithë familjarë. Kemi
22 nevojë që jemi me familjet tona por, nga ana tjetër jemi të
23 ndërgjegjshëm që duhet të vendosim se duhet që të punojmë
24 gjatë korrikut dhe gushtit, përfshirë dhe gushtin këtu pra,
25 shpresojmë, për herë të parë të punojmë në terren.

1 E pranojmë nxjerrjen e bërë në bazë të rregullit
2 102(1) (b) më 30 korrik dhe besoj nga fillimi i shtatorit,
3 besoj 3 shtator 2021, në bazë të rregullit 102(3). Pra,
4 propozojmë që në shtator të jetë konferenca e ardhshme për
5 ecurinë e çështjes. Por, ju lutem shumë, që të mbahen parasysh
6 të gjithë afatet dhe elementet të cilat priten nga ne për t'i
7 bërë gjatë kësaj periudhe.

8 Në shtator do të na duhet gjithashtu që të bëjmë të ditur
9 materialet që dëshirojmë që të shohim nga lista e ZPS-së.
10 Afati për ta bërë këtë gjë është 17 shtator 2021. Pra,
11 shtatori do të jetë disi i ngarkuar.

12 I nderuar Gjykatës, ju falënderoj për vëmendjen dhe për
13 mirëkuptimin e situatës sonë nga ana juaj.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.
15 Unë që në fillim desha që të përmend se dua që t'i jap
16 Mbrojtjes të gjithë kohën e nevojshme për të dorëzuar mocionet
17 paraprake siç e thoni ju. Sepse, siç e thoni ju, pra, është
18 një element shumë i rëndësishëm i procedurës dhe synoj që të
19 dyja palëve t'i jap nevojën e duhur të nevojshme për t'u
20 përgatitur sa më mirë.

21 E kuptoj nga parashtrimet tuaja se ju dëshironi që të
22 jeni në gjendje që të dorëzoni mocionet tuaja paraprake më
23 datë 11 korrik. Nuk më duket e gabuar që 11 korriku është e
24 diel, duhet ta kontrolloj. Po atëherë i bie që juve do t'i
25 dorëzoni më datë 12 korrik, që nuk është ditë pushimi?

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kjo do të ishte më mirë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.

3 Përpara se t'i jap fjalën prokurorisë, i informoj palët
4 se nuk synoj të vendos asnjë afat gjatë periudhës së pushimit
5 të Gjykatës, me përjashtim të çështjeve urgjente dhe çështjeve
6 që kanë të bëjnë me mbajtjen në paraburgim. Kjo është një
7 praktikë që është përdorur në të gjitha çështjet gjyqësore.
8 Mendoj se të gjitha palët dhe pjesëmarrësit kanë nevojë që të
9 pushojnë, kështu që, të gjitha ato afate që bien gjatë
10 pushimit do të shtyhen mbas periudhës së pushimit të Gjykatës.

11 Zoti prokuror, pikë së pari, cili është mendimi juaj sa i
12 takon datës 11 korrik që Mbrojtja të dorëzojë mocionin
13 paraprak? Keni ndonjë argument kundër? Dhe, të mos i kthehemi
14 çështjes së diskutuar më përpara. Deri tani, pra, nxjerrjet
15 tuaja në bazë të 102(1)(a) do të finalizoheshin apo jo më
16 datën 19 maj apo 11 qershor? Dhe kjo është pyetja e parë.

17 Dhe pyetja e dytë: sa kohë do t'ju duhet që të dorëzonit
18 përgjigjen tuaj ndaj mocioneve paraprake?

19 Pra, cila do të ishte një datë e mirë për ju që të jepnit
20 përgjigjen tuaj për mocionin paraprak.

21 Zoti prokuror fjala është për ju.

22 Z. O'DOWN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës,
23 siç i kemi informuar kolegët tonë të Mbrojtjes, nuk kemi
24 kundërshtim për shtyrjen e afatit.

25 Sa i takon datës së përgjigjes, mendoj se dy javë do të

1 ish in me shumë gjasë, të mjaftueshme për t'ju përgjigjur
2 mocioneve të tyre.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra afati, nëse afati për
4 Mbrojtjen do të ishte 12 korrik, do të thotë që 26 korriku do
5 ishte dy javëshi që është brenda periudhës së pushimit për
6 Gjykatën. Ta vendos [në] fundin e periudhës së pushimit të
7 Gjykatës apo mesin e periudhës së pushimit të Gjykatës, që të
8 keni dy javë të plota?

9 Z. O'DOWN: [Përkthim] Për të qenë më të sigurtë do të
10 sugjeroja fundin e periudhës së pushimit të Gjykatës.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 T'i kthehem tani Mbrojtjes, sepse kam parasysh edhe
13 nevojën që ka për pushime ekipi i Mbrojtjes. Sepse besoj se ju
14 do të keni nevojë për ditë pune, reale pune për të përgatitur
15 kundërpërgjigjen.

16 Atëherë afati, nëse afati për Prokurorinë që të dorëzonte
17 përgjigjen do të ishte fundi i periudhës së pushimit, që i bie
18 ditë e premte, 13 gusht, sa kohë do t'ju duheshit juve për
19 kundërpërgjigjen?

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
21 Mirdita të gjithëve.

22 Sa i takon afatit për kundërpërgjigjen e Mbrojtjes,
23 mendojmë se dy javë të plota do të ish in të mjaftueshme për
24 Mbrojtjen për të dorëzuar kundërpërgjigjen, besoj që, më duket
25 i bie, data 27 gusht. Faleminderit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë t'ua propozoj të
2 gjitha palëve.

3 Propozimi që Mbrojtja mocionin paraparak ta dorëzojë
4 brenda datës 12 korrik; atëherë, përgjigja e ZPS-së brenda
5 datës 13 gusht, ditë e premte; dhe pastaj përgjigja,
6 kundërpërgjigja e Mbrojtjes brenda ditës së hënë, 30 gusht. A
7 është i pranueshëm për të dyja palët ky kalendar?

8 Së pari Mbrojtja, z. Gilissen.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po. Faleminderit shumë. Ju
10 falënderoj për këtë.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zoti prokuror.

12 Z. O'DOWN: [Përkthim] Po, faleminderit, i nderuar
13 Gjykatës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani që i dëgjova palët,
15 do të jap një urdhër të dytë gojarisht sa i takon mocioneve
16 paraprake dhe afateve për to.

17 Unë këtu, me këtë vendim e ndryshoj afatin për dorëzimin
18 e mocioneve paraprake dhe e urdhëroj Mbrojtjen e z. Shala që
19 të dorëzojë mocionin paraparak jo më vonë se data 12 korrik
20 2021; ZPS-në që t'i përgjigjet jo më vonë se ditës së premte,
21 13 gusht 2021; dhe Mbrojtjen që të dorëzojë kundërpërgjigjen
22 jo më vonë se data 30 gusht 2021, ditën e hënë.

23 Këtu mbyllet urdhri im i dytë i dhënë gojarisht.

24 Tani dëshiroj që t'u lutem palëve nëse kanë ndonjë
25 çështje tjetër që dëshirojnë që të ngrenë. E vë re që Mbrojtja

1 ka ngritur këtu çështjen e kushteve të mbajtjes në paraburgim
2 në parashtrimet me shkrim, dëshiroj që të dëgjoj palët lidhur
3 me këtë.

4 Në fillim zoti prokuror.

5 Z. O'DOWN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kemi asnjë
6 çështje tjetër për të ngritur në këtë moment.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
8 prokuror.

9 Ja jap fjalën tani Mbrojtjes, z. Gilissen.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Atëherë, faleminderit shumë z.
11 Gjykatës.

12 Kemi disa probleme të tjera, të cilat ne do duam që t'i
13 ngremë dhe do të doja që të na ndihmoni që t'i trajtonim ato
14 dhe shpresoj që të mos kemi nevojë që të vijmë përpara jush
15 për zgjidhjen e tyre.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.
17 Për çështje të Mbrojtjes, pra, që kanë të bëjnë me
18 paraburgimin do të doja që t'ju ftoja që së pari t'i
19 drejtoheni Zyrës së Administrimit, sepse në të shkuarën Zyra e
20 Administrimit ka dhënë zgjidhje efektive dhe efikase për sa i
21 takon kërkesave të Mbrojtjes.

22 Zonja administratore, a dëshiron të shtosh ndonjë gjë sa
23 i takon kësaj çështje dhe situatës së Covid-it?

24 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
25 Gjykatës.

1 Lidhur me çështjet e tjera të cilat janë ngritur nga
2 Mbrojtja lidhur me kushtet e paraburgimit, ne jemi të kënaqur
3 që janë gjetur zgjidhje për problemet e ngritura nga Mbrojtja
4 dhe kërkesa që janë ngritur nga z. Shala janë trajtuar nga
5 zyra e shefit të paraburgimit dhe autoritetet përkatëse.

6 Sa i takon kufizimeve që ekzistojnë si rezultat i
7 pandemisë, është kënaqësi e imja për t'ju informuar që, në
8 konsultime me mjekun e objektit të paraburgimit, ne po
9 fillojmë që të heqim një pjesë të këtyre kufizimeve dhe kohët
10 e fundit ne kemi dhënë edhe përditësime për palët e
11 interesuara duke thënë që është synimi ynë që nga data 15
12 korrik, ne të mund të lejojmë vizita fizike të familjarëve në
13 objektin e paraburgimit. Pra, do të dua që të marrim parasysh
14 gjithashtu edhe zhvillimet me variantin Delta të Corona
15 Virusit dhe gjithashtu edhe, me vaksinimet edhe me gjendjen e
16 skuadrës së Mbrojtjes. Pra, edhe njëherë do doja të thoja që
17 do të kemi mundësi që të mund të lejojmë takime fizike
18 ndërmjet të të pandehurve dhe mbrojtjeve të tyre.

19 Pra, megjithatë do të doja të thosha që deri tani takimet
20 me familjarët janë organizuar përmes Zoom-it dhe ndërkohë ne
21 jemi munduar që të krijojmë të gjitha kushtet e nevojshme për
22 tu takuar Mbrojtja me të akuzuarit. Por, siç e thashë edhe më
23 përpara, do të doja të theksoja dhe një herë që ne
24 parashikojmë progres për këtë çështje në të ardhmen e afërt.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë, zonja

1 administratore. Ju falënderojmë për të gjithë përpjekjet për
2 të lehtësuar komunikimin ndërmjet të të akuzuarve dhe
3 Mbrojtjes, po gjithashtu edhe të të akuzuarve dhe familjarëve
4 të tyre.

5 Z. Gilissen!

6 Z. GILISSEN: [Përkthim] I nderuar zoti Kryetar. Unë ju
7 kërkoj shumë ndjesë që harrova që të falënderoj
8 administratoren për ndihmën e jashtëzakonshme që na ka dhënë.
9 Ne kemi marrë ca zgjidhje për problemet që kemi për shkak të
10 ndërhyrjes së saj.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.
12 Jam i kënaqur që e dëgjoj këtë gjë.

13 Tani do të doja që të dëgjoja palët për pikëpamjet e tyre
14 për konferencën e ardhshme të ecurisë së çështjes.

15 Z. Gilissen, ju thatë që preferoni shtatorin apo jo?

16 Zoti prokuror, nuk e di në qoftë se keni ndonjë
17 preferencë për datën e konferencës së ardhshme për ecurinë e
18 çështjes? Mbase dëshironit që konferenca tjetër të organizohet
19 pasi ju [të] keni dhënë dokumentet që kanë të bëjnë me
20 njoftimin sipas rregullit 102(3)?

21 Z. O'DOWN: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
22 Ne jemi të disponueshëm kurdo që ta mendoni të arsyeshme ju.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti
24 prokuror.

25 Z. Gilissen, fjala për ju.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, faleminderit z. Kryetar. Në
2 qoftë se është e mundur, do të ishte mirë që konferenca për
3 ecurinë e çështjes të organizohet në gjysmën e dytë të
4 shtatorit. Mua më duhet që të kem një ndërhyrje shëndetësore
5 në fillim të shtatorit, kështu që do të ishte mirë, në qoftë
6 se konferenca do të organizohej pasi unë të zgjidhja atë
7 problemin shëndetësor që kam.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gilissen.
9 A do të ishte e mundur në javën e 12 shtatorit apo duket sikur
10 është shumë herët kjo datë? Po e them këtë gjë, po ju pyes
11 sepse ndoshta salla e gjyqit jo gjithmonë do të jetë e
12 disponueshme për ne nga mesi i shtatorit e në vijim, ndërkohë
13 që unë dëshiroj që konferencën e radhës për ecurinë e çështjes
14 të mund ta organizojmë këtë javë, domethënë javën që fillon më
15 13 shtator. A mendoni se është e mundur që ju të merrni pjesë
16 në seancë?

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se është e
18 mundur që ta shtynim për një javë më pas, për mua do të ishte
19 më mirë në qoftë se do ta shtynin për një javë më pas
20 konferencën për ecurinë e çështjes.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, për
22 ndërhyrjen. Do të shikoj se çfarë është e mundur në varësi të
23 kalendarit.

24 Prokuroria. Pra, thjeshtë -- z. Aouini.

25 Z. AOUIINI: [Përkthim] Po. Do të doja t'ju thoja që ne

1 kemi afatin kohor të datës 17 shtator për të përzgjedhur për
2 sa i takon materialeve provuese, kështu që bëhet fjalë për
3 mijëra faqe dokumentesh që duhet të përzgjidhen prej nesh.
4 Kështu që do të jemi goxha të zënë nga data 3 deri në datën 17
5 shtator, kështu që do t'ju kërkoja që të merrni parasysh dhe
6 këtë gjënë nëse është e mundur.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

8 Atëherë nuk shoh palë të tjera ose pjesëmarrës të tjerë
9 që dëshirojnë të marrin fjalën. Do të merrni, pra rendin e
10 ditës për konferencën e ardhshme për ecurinë e çështjes në
11 kohën e përshtatshme.

12 Kemi arritur në përfundim të seancës publike të ditës së
13 sotme. Do të doja të falënderoj palët, administratoren edhe si
14 gjithmonë, do të dua që të falënderoj stenografët,
15 përkthyesit, teknikët audioviziv dhe personelin e sigurimit
16 për ndihmën e tyre.

17 Takimi përfundon këtu. Të gjithë në këmbë.

18 --- Konferenca për ecurinë e çështjes përfundoi në
19 orën 11:45

20

21

22

23